

VENDIM
Nr. 4, datë 11.3.2019

**PËR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË KANDIDATËVE PËR POZICIONET
VAKANTE NË GJYKATËN KUSHTETUESE DHE TË INSPEKTORIT TË LARTË TË
DREJTËSISË**

*(Ndryshuar me vendimin nr. 3, datë 6.2.2020; me vendimin nr. 6, datë 10.7.2020; me vendimin nr. 2, datë
23.2.2022; me vendimin nr. 4, datë 23.11.2023)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 229, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

I. Dispozita të përgjithshme

1. Ky vendim përcakton rregulla më të hollësishme lidhur me procedurat që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (*Këshilli*) zhvillon për verifikimin e pasurisë, integritetit, të shkuarës profesionale dhe personale, si edhe të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore që duhet të plotësojnë kandidatët për t'u zgjedhur në pozicionet vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për inspektorë të lartë të drejtësisë.

2. Përcaktimi në këtë vendim i rregullave më të hollësishme mbi procedurat e verifikimit të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe inspektorë të lartë të drejtësisë kanë për qëllim realizimin e kësaj procedure duke u bazuar në meritat e kandidatëve dhe duke respektuar procesin e rregullt ligjor, si edhe parimet e përgjithshme të procedurës administrative, veçanërisht ato të ligjshmërisë, transparencës, informimit, të drejtësisë, të paanësisë, të mbrojtjes së të dhënave, konfidencialitetit e të sekretit shtetëror.

II. Rregulla të përgjithshme të procedurës së verifikimit

A. Fillimi dhe fazat e procedurës së verifikimit

3. Procedura administrative e verifikimit të kandidatëve fillon në ditën e zhvillimit të mbledhjes së Këshillit. Mbledhja zhvillohet brenda 5 ditëve nga depozitimi në sekretarinë e Këshillit të dokumentacionit dhe listës së kandidatëve për pozicionin vakant në Gjykatën Kushtetuese nga subjektet që vënë në lëvizje Këshillin e Emërimeve në Drejtësi dhe publikimit të listës së kandidatëve për pozicionin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga ana e këtij Këshilli.

4. Në të njëjtën ditë të mbledhjes së Këshillit zhvillohet edhe procedura e shortit për caktimin, ndërmjet anëtarëve të Këshillit, të relatorit për secilin pozicion vakant në çdo institucion. Në çdo rast, procedura e shortit zhvillohet brenda afatit 5-ditor të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi.

4/1. Kur procedura e verifikimit nuk ka përfunduar gjer më 31 dhjetor, atëherë afati i përcaktuar në pikat 3 dhe 4 është jo më vonë se 3 ditë nga dita e konstituimit të Këshillit të radhës. I njëjti afat zbatohet edhe kur procedohet me zëvendësimin e relatorit për shkak të ligjshëm gjatë veprimtarisë së të njëjtit Këshill.

5. Procedura administrative e verifikimit të kandidatëve realizohet në dy faza:

- a) veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit;
- b) shqyrtimi dhe miratimi i projektaktit të verifikimit nga Këshilli.

5/1. Kur veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit nuk kanë përfunduar gjer më 31 dhjetor, atëherë relatori i ri kontrollon saktësinë dhe plotësinë e veprimeve të kryera për të përfunduar me përparësi këtë fazë, duke konsideruar respektimin e afatit ligjor.

5/2. Kur relatori i ka përfunduar veprimet procedurale dhe verifikuese, por Këshilli nuk ka shqyrtuar çështjen gjer më 31 dhjetor, atëherë relatori i ri, pasi kontrollon saktësinë dhe plotësinë e veprimeve të kryera:

- a) konfirmon procedurën e ndjekur dhe përgjell relacionin e hartuar prej tij për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit;
- b) vijon kryerjen e veprimeve procedurale dhe verifikuese shtesë.

B. Të drejtat e kandidatit

6. Kandidati ka të drejtë që, në çdo fazë të procedurës së verifikimit, me kërkesën e tij, të njihet me dokumentet e dosjes së kandidimit dhe aktet procedurale të kryera nga relatori dhe Këshilli për verifikimin e kandidaturës, si edhe të marrë kopje të tyre, sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative dhe atyre të përcaktuara në këtë vendim.

7. Kryesisht apo mbi kërkesën e Këshillit, kandidati ka të drejtë të paraqesë shpjegime me shkrim për faktet, rrethanat apo çështjet ligjore të lidhura me kandidimin e tij/saj, si dhe të depozitojë dokumente shkresore shtesë, në mbështetje të këtyre shpjegimeve, *jo më vonë se afatet e përcaktuara nga relatori në zbatim të pikave 22, 23, 26, 27 dhe 48. Me kalimin e këtyre afateve çdo pretendim i paraqitur nga kandidati nuk do të merret në konsideratë.*

8. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Këshillin. Pas këtij njoftimi, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit. Akti i Këshillit për konstatimin e tërheqjes nga kandidimi i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

C. Afatet dhe llogaritja e tyre

9. Afatet në procedurën e verifikimit të kandidatëve caktohen në ditë kalendarike.

10. Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në ligj ose në këtë Vendim, në llogaritjen e afatit përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati.

11. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.

12. Dita e fundit e afatit të kryerjes së veprimit procedural, paraqitjes së kërkesave dhe shpjegimeve, vazhdon deri në orën 24 të saj. Afati nuk quhet i humbur, kur kërkesa, shpjegimet ose akti është dërguar me postë edhe në ditën e fundit të afatit.

Ç. Njoftimet

13. Njoftimet e Këshillit drejtuar kandidatit gjatë procedurës së verifikimit bëhen me shkresë, në adresën postare ose në adresën elektronike të deklaruar për këtë qëllim nga kandidati, pranë Këshillit ose subjektit ku ka paraqitur kandidaturën.

14. Njoftimet dhe kërkesat e kandidatit drejtuar Këshillit bëhen me shkrim, duke i depozituar drejtpërdrejt pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë ose në adresën elektronike të Këshillit, e cila i është bërë e njohur për këtë qëllim secilit kandidat, me fillimin e procedurave të verifikimit të kandidaturave.

15. Kandidati, në ditën e thirrjes nga Këshilli për t'u pajisur me formularët e deklarimit dhe të autorizimeve sipas ligjit dhe këtij vendimi, deklaron me shkrim adresën postare dhe adresën elektronike për efekt të komunikimit dhe njoftimeve me Këshillin *së bashku me të dhënat personale të nevojshme për krijimin e llogarisë fillestare në sistemin EACIDS (email primar, numër telefoni dhe NID)*. Njëkohësisht, për efekt të pranimit të njoftimeve që dërgon, kandidati njihet me adresat zyrtare elektronike të Këshillit.

16. Kandidati ka detyrimin të njoftojë menjëherë me shkrim Këshillin për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës postare dhe elektronike të deklaruar.

III. Fazat e procedurës administrative të verifikimit të kandidatëve

A. Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit

17. Procedura administrative e verifikimit të kandidatëve fillon dhe zhvillohet njëkohësisht për të gjitha kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

18. Pas caktimit me short, relatori ndjek dhe kryen të gjitha veprimet procedurale dhe verifikuese të lidhura me proceset e ndryshme të verifikimit të përmbushjes së kushteve dhe kritereve të tjera ligjore nga secili kandidat.

19. Në kryerjen e detyrës, relatori mbështetet nga këshilltarët ligjorë dhe personeli administrativ i Gjykatës së Lartë, të cilët, kanë detyrimin të ndjekin procedurat, të kryejnë veprimet dhe të përgatisin aktet përkatëse, sipas udhëzimeve të relatorit.

20. Krahas veprimeve procedurale dhe verifikuese të tjera që i vlerëson të nevojshme rast pas rasti, për secilin kandidat, relatori realizon procedurat standarde si më poshtë:

- a) *mbledhjen e të dhënave personale të kandidatit të nevojshme për krijimin e llogarisë fillestare në sistemin EACIDS;*
- b) pajisjen e kandidatit me formularin për vetëdeklarim sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
- c) pajisjen e kandidatit me formularin e aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta”, në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015;
- ç) pajisjen dhe marrjen në dorëzim të nënshkruar të formularëve për dhënien e miratimit për përpunimin e të dhënave personale;
- d) pajisjen dhe marrjen në dorëzim të nënshkruar të formularëve autorizues për verifikimin, në të gjitha subjektet publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave që lidhen me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit;
- dh) pajisjen dhe marrjen në dorëzim të nënshkruar nga kandidati të formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës;
- e) dërgimin e shkresave standarde për kërkimin e informacionit dhe të shpjegimeve përkatëse nga kandidati, institucionet publike dhe subjektet private, në lidhje me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

ë) pajisjen e kandidatit me formularin e vetëdeklarimit për pozicione drejtuese të mbajtura në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, sipas modelit të përcaktuar në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

20/1. *Kur akti apo shkresa e komunikimit për mbledhjen e të dhënave nga të tretët nënshkruhet nga Kryetari, atëherë përmbajtja e aktit apo e shkresës konfirmohet paraprakisht përmes nënshkrimit/siglimit ose postës elektronike nga relatori përkatës, praktikë e cila vendoset në dosjen e kandidatit.*

21. Në rastin e kandidatëve që rezultojnë, njëkohësisht, të kandiduar në më shumë se një pozicion vakant në proces shqyrtimi nga Këshilli, relatorët përkatës të pozicioneve vakante, realizojnë bashkërisht procedurat standarde verifikuese të përcaktuara në pikën 20 të këtij vendimi.

22. Pas caktimit me short, relatori njofton menjëherë zyrtarisht kandidatin për fillimin e procedurave të verifikimit të kandidaturës dhe për detyrimin për t’u paraqitur, jo më vonë se 3 ditë nga ajo e njoftimit, në zyrën e posaçme të Këshillit pranë Gjykatës së Lartë, për t’u pajisur me formularët e deklarimeve dhe të autorizimeve të përcaktuara në pikën 20 të këtij vendimi. Në pamundësi objektive për t’u paraqitur brenda afatit 3-ditor, kandidati njofton menjëherë relatorin duke i parashtruar edhe motivet përkatëse. Relatori, kur motivet janë të justifikuara, i cakton kandidatit një afat të ri të arsyeshëm për t’u paraqitur pranë Këshillit.

22/1. *Kur kandidati, pa shkaqe të arsyeshme, nuk paraqitet brenda afatit 3 ditor të kërkuar nga relatori, apo nëse nuk dorëzon dokumentacionin e tërhequr apo autorizimet, sipas parashikimeve të pikës 22, brenda 5 ditëve nga momenti i tërheqjes së tyre në sekretarinë e Këshillit, relatori ndërpret procedurën për këtë kandidat dhe përgatit relacionin dhe projektvendimin për mosshqyrtimin e kandidaturës, duke ia dërguar menjëherë për shqyrtim KED-it.*

23. *Shqyrtimi i kandidaturave të paraqitura bëhet në bazë të dokumentacionit shoqëruar të paraqitur nga kandidati me të cilin vërtetohet plotësimin e kushteve dhe kritereve ligjore. Lista e dokumenteve që duhet të paraqesë*

kandidati me të cilën vërtetohet plotësimin e kushteve dhe kritereve ligjore është sipas lidhjes nr. 2 të këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Nëse nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, relatori konstaton dhe vlerëson se ai është i paplotë, njofton menjëherë kandidatin për të përmbushur detyrimin e plotësimit të tij sipas ligjit, duke i caktuar një afat jo më shumë se 5 ditë për dorëzimin e tij pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë, dhe për arsye të justifikuar, mund ta shtyjë afatin, me kërkesë të kandidatit, dhe 5 ditë tjera. Njoftimi përmban shënimin se në rast të mosparaqitjes së dokumenteve brenda afatit, procedura e shqyrtimit të kandidaturës ndërpritet. Kur kandidati nuk plotëson të metat e dokumentacionit brenda afatit të caktuar nga relatori, çdo veprim tjetër i kryer lidhur me këtë kandidat ndërpritet dhe relatori përgatit relacionin dhe projektvendimin për mosshqyrtimin e kandidaturës, duke ia dërguar menjëherë për shqyrtim KED-it.

24. Pas realizimit të procedurave të parashikuara në pikat 22 dhe 23 të këtij vendimi, relatori procedon me dërgimin e shkrësive standarde për kërkimin e informacionit zyrtar që disponojnë institucionet publike si dhe kur lind nevoja e verifikimit të të dhënave dhe shpjegimeve të paraqitura nga kandidati, pranë institucioneve publike dhe subjekteve private.

25. Në procedurën e verifikimit, relatori shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga secili kandidat, formularët e deklarimeve të plotësuar, aktet e dërguara nga organet e ngarkuara me ligj për kontrollin dhe verifikimin e deklarimeve të kandidatëve, si edhe çdo akt, informacion dhe të dhënë tjetër të dërguar nga subjektet publike dhe private, me nismën e tyre ose mbi kërkesën e Këshillit apo që relatori vlerëson se ka lidhje me gjykimin mbi plotësimin ose jo të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore për kandidim.

26. Bazuar në gjetjet e procedurës së verifikimit, nëse vlerëson paraprakisht që mund të procedohet me urdhërimin e lejimit ose të ndalimit të kandidimit, relatori njofton kandidatin e verifikuar lidhur me gjetjet paraprake, si edhe për të drejtën që:

a) brenda një afati 5-ditor nga dita e njoftimit, të paraqesë me shkrim, drejtpërdrejt pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë ose në rrugë elektronike, qëndrimin dhe shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit, si edhe të dokumentacionit mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të kandidatit;

b) të tërheqë, sipas rastit, kopje të dokumentacionit dhe të akteve të këtij procedimi administrativ ose të asaj pjesë të tyre që lidhet me verifikimin e kushteve dhe kritereve përkatëse ligjore për të cilat relatori ka vlerësuar paraprakisht se mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastet kur kandidati nuk zbaton parashikimet në pikat 22 dhe 23 të këtij vendimi.

27. Në pamundësi objektive ose për motive të tjera të justifikuar për të paraqitur qëndrimin dhe shpjegimet brenda afatit 5-ditor, kandidati njofton menjëherë Këshillin, duke i parashtruar edhe motivet përkatëse. Kur i vlerëson motivet si të justifikuar, relatori i cakton kandidatit një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur qëndrimet dhe shpjegimet lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.

28. Në rastin kur, në përfundim të afatit të njoftimeve sipas pikave 26 dhe 27 të këtij vendimi, kandidati nuk paraqitet, nuk i përgjigjet njoftimeve të Këshillit, nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar ose nuk parashtron shpjegime me shkrim për gjetjet e procedurës së verifikimit, relatori procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe problemet ligjore të konstatuara dhe dërgimin menjëherë të çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

29. Nëse në përfundim të këtyre procedurave administrative për verifikimin e kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit, relatori vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen e çështjes dhe të relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

30. Nëse vlerëson që kandidati nuk përmbush ndonjërin prej kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit, relatori procedon me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe dërgimin menjëherë të çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit, pa qenë i nevojshëm kryerja e procedurës së verifikimit për të gjitha kushtet dhe kriteret e tjera ligjore.

31. Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projektaktin mbi përfundimin e procedurës administrative të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

32. Kur gjatë zhvillimit të procedurave të verifikimit, për shkak të tërheqjes nga kandidimi apo të vendimit të ndalimit nga kandidimi, relatori përkatës i pozicionit vakant konstaton se numri i kandidatëve, për atë pozicion vakant në Gjykatën Kushtetuese ose të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përkatësisht, zbret në më pak se 3 dhe 5 kandidatë, njofton menjëherë Kryetarin, i cili thërret mbledhjen e Këshillit për të vendosur mbi mënyrën e procedimit të mëtejshëm me atë pozicion vakant.

B. Shqyrtimi dhe miratimi i projektaktit të verifikimit nga Këshilli

33. Kryetari i Këshillit, menjëherë pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Këshillit, duke i dërguar anëtarëve edhe materialet e çështjes. Mbledhja zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga ajo e njoftimit të relatorit.

34. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i njoftohet kandidatit të verifikuar dhe subjekteve që ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit sipas ligjit. Avokatit të Popullit i dërgohet edhe dokumentacioni i përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera prej tij gjatë procedurës së ndjekur për verifikimin e kandidatit. Ky njoftim bëhet publik edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

35. Në mbledhjen e Këshillit marrin pjesë anëtarët. Gjithashtu, marrin pjesë Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e subjekteve që ftohen sipas ligjit, mosparaqitja e të cilëve nuk përbën shkak për shtyrjen e mbledhjes.

36. Mbledhja e Këshillit është e vlefshme nëse marrin pjesë së paku 5 anëtarë të tij.

37. Kryetari i Këshillit fton relatorin e çështjes që të paraqesë përmbledhjen e procedurave, të fakteve dhe të gjetjeve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurave për verifikimin e përmbushjes së kushteve dhe kritereve të tjera ligjore nga kandidati i verifikuar.

38. Në përfundim të parashtrimeve të relatorit, nëse vlerësojnë, anëtarët e Këshillit mund t'i drejtojnë pyetje dhe të kërkojnë shpjegime të natyrës sqaruese.

39. Pas anëtarëve të Këshillit, nëse e vlerëson, Avokati i Popullit mund të parashtojë mendime dhe vlerësime vetëm në lidhje me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit.

40. Nëse anëtarët e Këshillit nuk parashtojnë pyetje dhe kërkesa të tjera sqaruese në drejtim të relatorit, Këshilli deklaron kalimin në fazën e bisedimit, votimit dhe të dhënies së vendimit.

41. Bisedimet e çështjes, si edhe votimi i vendimit bëhen vetëm nga anëtarët e Këshillit. Avokati i Popullit merr pjesë në cilësinë e vëzhguesit në funksion të transparencës dhe besimit të publikut.

42. Këshilli, pasi dëgjon paraprakisht diskutimin e relatorit, bisedon dhe vendos për të gjitha çështjet që parashtrohen në relacionin e përgatitur prej tij ose që vlerësohen nga anëtarët.

43. Në përfundim të bisedimeve, për zgjidhjen e çështjes, i pari voton relatori, dhe me radhë nga anëtarët e tjerë, sipas renditjes së përbërjes së Këshillit që rezulton nga përzgjedhja me short e anëtarëve nga Presidenti apo Kuvendi. *Kryetari i Këshillit voton i fundit.*

44. Vendimet e Këshillit në lidhje me procedurën e verifikimit të kandidatëve merren me shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit që marrin pjesë në mbledhje. Abstenimi nuk lejohet. Në rast të barazisë së votave, kandidimi konsiderohet i lejuar.

45. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit që kanë marrë pjesë në dhënien e tij. Anëtari, mendimi i të cilit ka mbetur në pakicë, shkruan fjalën “kundër” dhe nënshkruan vendimin.

46. Nëse për shkak të natyrës së çështjes, arsyetimi i vendimit kërkon kohë, Këshilli mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari, jo më vonë se 3 ditë nga ajo e shpalljes.

47. Përveç rastit kur ka mbetur në pakicë, arsyetimi i vendimit të Këshillit bëhet nga relatori i çështjes. Anëtari që ka mbetur në pakicë, arsyeton qëndrimin e tij, i cili i bashkohet vendimit.

48. Në rastin kur relatori paraqet relacionin e kandidatit për shqyrtim Këshillit dhe pas shqyrtimit të relacionit dhe të akteve që përmban dosja e kandidatit të verifikuar, Këshilli vjen në përfundimin që ka vend për të vlerësuar edhe mundësinë e ndalimit të kandidimit, si dhe për këtë kandidat nuk janë ndjekur procedurat e përcaktuara në pikat 26 dhe 27 të këtij vendimi, ndërpret shqyrtimin e këtij kandidati.

Kandidatit të verifikuar i njoftohet materiali me gjetjet dhe motivet të cilat mund të sjellin ndalimin e kandidimit, duke i njohur të drejtën e parashtrimit me shkrim të shpjegimeve të tij dhe dokumenteve mbështetës, jo më vonë se 5 ditë nga ajo e ardhjes në dijeni të materialit të dërguar nga Këshilli. Në përfundim të këtij afati, Këshilli shpall caktimin e një seance tjetër për shqyrtimin e kësaj kandidature.

49. Në rastet e parashikuara në pikën 32 të këtij vendimi, në përfundim të bisedimit të çështjes, Këshilli mund të vendosë pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe:

a) njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për pozicionin vakant të gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese;

b) rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për pozicionin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

50. Në rastet e tjera, pas bisedimit dhe votimit të çështjes në dhomën e këshillimit, Këshilli vendos:

a) lejimin e kandidimit;

b) ndalimin e kandidimit;

c) vijimin e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

51. Këshilli vendos ndalimin e kandidimit nëse kandidati nuk përmbush qoftë edhe njërin nga kushtet ose kriteret e tjera ligjore të kandidimit, duke u bazuar në të dhënat që përmbajnë:

a) deklaratimet dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati;

b) gjetjet dhe përfundimet e organeve kompetente të kontrollit të pasurisë dhe të integritetit të kandidatit, si edhe informacionet e subjekteve të tjera publike dhe private dërguar në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit.

52. Këshilli vendos ndalimin e kandidimit edhe në rastet kur, pas njoftimeve të Këshillit gjatë procedurës së verifikimit, kandidati përsëri nuk i përmbush detyrimet për paraqitjen ose plotësimin e deklaratave, autorizimeve dhe të dokumentacionit lidhur me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit të parashikuara nga ligji.

C. Akti i verifikimit. E drejta e ankimit

53. Vendimi i Këshillit për procedurën e verifikimit të kandidatit është i arsyetuar dhe hartohet sipas kërkesave të nenit 99 të Kodit të Procedurave Administrative lidhur me formën dhe përmbajtjen e aktit administrativ.

54. Në zbatim të nenit 238, të ligjit nr. 115/2016, vendimi i arsyetuar i Këshillit i njoftohet kandidatit, i cili, në rastin e ndalimit të kandidimit, vetëm për pretendime për shkelje të rënda procedurale, ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ç. Publikimi i akteve të procedurës së verifikimit. Komunikata për median

55. Vendimet e Këshillit për verifikimin e kandidaturave bëhen publike në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

56. Në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi publikohen edhe:

a) lista e kandidatëve për të cilët është vendosur ndalimi i kandidimit;

b) lista e kandidatëve për të cilët është vendosur lejimi i kandidimit;

c) përmbledhje e procesverbalit të nënshkruar nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në mbledhjen ku vendoset lejimi ose ndalimi i kandidimit;

ç) komunikata për median sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 233, të ligjit nr. 115/2016.

IV. Procedura të veçanta për verifikimin e kandidatëve

57. Përveç kur parashikohet ndryshe në seksionet A, B dhe C të këtij kreu, për zhvillimin e procedurës së verifikimit të pasurisë, integritetit dhe të kushteve të tjera ligjore të kandidatit, zbatohen rregullat e përgjithshme të parashikuara në kreun II dhe kreun III të këtij vendimi.

A. Verifikimi i pasurisë së kandidatit

58. *Jo më vonë se 3 ditë nga dita e njoftimit zyrtar për fillimin e procedurës së verifikimit, kandidati paraqitet në zyrën e posaçme të Këshillit, pranë Gjykatës së Lartë, për të dorëzuar autorizimet, si dhe të dhënat personale të nevojshme për krijimin e llogarisë në sistemin EACIDS nga ana e ILDKPKI-së.*

Për mënyrën dhe procedurën e plotësimit të deklaratës së pasurive dhe interesave private, kandidati duhet të zbatojë aktet e miratuara nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së për këtë qëllim.

59. Njëkohësisht, kandidati pajiset me formularët e autorizimeve për Këshillin që, në zbatim të pikës 4 të nenit 229, të ligjit nr. 115/2016, të kryejë verifikimin në të gjitha subjektet publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit dhe personave të lidhur. Autorizimet, të nënshkruar rregullisht, nga kandidati dhe personat e lidhur, depozitohen pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë, jo më vonë se 5 ditë nga ajo e marrjes në dorëzim.

60. *Jo më vonë se 5 ditë nga dita e depozitimit në Këshill të autorizimeve, të nënshkruara rregullisht nga kandidati dhe personat e lidhur:*

a) Këshilli i dërgon ILDKPKI-së listën e kandidatëve që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas ligjit nr. 115/2016, *së bashku me të dhënat e tyre personale, të nevojshme për krijimin e llogarisë në sistemin EACIDS;*

b) *Shfuqizuar.*

61. *Jo më vonë se 15 ditë nga dita e krijimit të llogarisë nga ana e ILDKPKI-së, kandidati e dorëzon formularin e plotësuar të deklarimit të pasurisë:*

a) *në formë elektronike, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS; dhe*

b) *në formë shkresore, duke printuar dhe nënshkruar në çdo fletë deklaratën e pasurisë, të plotësuar në formë elektronike, e cila dorëzohet e mbyllur në zarf pranë ILDKPKI-së.*

62. ILDKPKI-ja njofton menjëherë Këshillin në rastin kur kandidati nuk e dorëzon të plotësuar formularin e deklarimit të pasurisë ose kur kandidati e dorëzon jashtë afatit të parashikuar në pikën 61 të këtij vendimi.

63. ILDKPKI-ja kryen kontrollin e plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe interesave private të kandidatit jo më vonë se 30 ditë nga paraqitja e kësaj deklarate pranë ILDKPKI-së.

64. Nëse gjatë 180 ditëve para asaj të paraqitjes së deklaratës, kandidati i është nënshtruar kontrollit të plotë nga ILDKPKI-ja dhe kontrolli nuk ka rezultuar në disfavor të tij, si edhe në rastin kur ILDKPKI-ja vlerëson se nuk është vendi për rikontroll të plotë sipas përcaktimit të pikës 4, të nenit 25/1, të ligjit nr. 9049/2003, atëherë kontrolli konsiderohet i kryer. ILDKPKI-ja i dërgon menjëherë Këshillit kopjen e deklarimit të bërë nga kandidati, si edhe gjetjet dhe përfundimet e këtij institucioni nga procedura e mëparshme e kontrollit të plotë të deklarimit. *Në çdo rast, Këshilli, nëse ka dyshime të arsyeshme kryen veprimet e parashikuara nga pika 67 fjalë e dytë e këtij vendimi.*

65. Pavarësisht parashikimit të pikës 64 të këtij vendimi, nëse pas fillimit të procedurës së verifikimit të kandidatit, relatori vjen në dijeni, nga burime të ligjshme, për rrethana që vënë në dyshim vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave që përmbahen në deklarimin e pasurisë së kandidatit, njofton menjëherë ILDKPKI-në për të ushtruar kompetencën e rikontrollit të plotë të deklarimit të kandidatit sipas parashikimeve neneve 3/1 dhe 25/1 pika 4, të ligjit nr. 9049/2003.

66. *Në përfundim të verifikimit të kryer sipas ligjit, ILDKPKI-ja i dërgon menjëherë Këshillit raportin e kontrollit të plotë për pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare të kandidatit dhe personave të lidhur, së bashku me dokumentacionin e administruar gjatë procedurës së verifikimit.*

67. Relatori shqyrton dhe verifikon rezultatet e kontrollit, gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI-së, si edhe dokumentacionin e dërguar prej këtij të fundit. Relatori kur ka dyshime të arsyeshme apo kur ka mospërputhje midis gjetjeve dhe përfundimeve të ILDKPKI-së, pas miratimit të Këshillit, fillon procedurat për kryerjen e veprimeve të kërkuar nga subjekte publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit dhe personave të lidhur.

68. Në varësi të rezultateve të kontrollit dhe nevojave të verifikimit të mëtejshëm të pasurisë, relatori mund të kërkojë:

a) informacione shtesë nga subjektet publike dhe private;

b) shpjegime me shkrim nga kandidati, i cili, jo më vonë se 5 ditë nga ardhja dijeni, duhet të paraqesë këto shpjegime dhe dokumente mbështetës drejtpërdrejt pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë. Nëse për motive të justifikuara nuk mund të respektojë afatin 5-ditor, kandidati njofton menjëherë Këshillin. Kur i vlerëson motivet si të justifikuara, relatori i cakton kandidatit një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur shpjegimet lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.

69. Në rastin kur në procedurën e verifikimit të pasurisë lind nevoja për njohuri të posaçme lidhur me konstatimin dhe sqarimin e të dhënave që rezultojnë nga deklaratimet e kandidatit, gjetjet dhe përfundimet e ILDKPI-së dhe atyre të sjella nga subjektet publike e private, relatori ka të drejtën të thërrasë ekspertë të fushës përkatëse.

70. Ekspertët përzgjidhen nga listat e përditësuara të subjekteve të licencuar për fushën përkatëse nga organi kompetent sipas ligjit ose ndërmjet atyre që e ushtrojnë veprimtarinë në institucione të specializuara.

71. Ekspertët caktohen nga Këshilli, mbi propozimet e parashtruara nga anëtari relator i pozicionit vakant. Shpenzimet e ekspertit përballohen nga buxheti i Gjykatës së Lartë.

72. Kandidati që verifikohet njoftohet menjëherë për ekspertin e caktuar nga Këshilli. Jo më vonë se 5 ditë nga ardhja dijeni, kandidati njofton Këshillin, duke parashtruar me shkrim edhe motivet konkrete përkatëse, nëse pretendon gjendjen e papajtueshmërisë apo të konfliktit të interesit me ekspertin. Lidhur me pretendimet e kandidatit, Këshilli disponon sipas ligjit.

73. Përpara fillimit të detyrës, eksperti nënshkruan formulën e betimit. Pas veprimit të betimit, sipas udhëzimeve të relatorit, eksperti ka detyrimin të shqyrtojë aktet, të përgatisë, sipas rastit, raport financiar apo mendimin e tij me shkrim, si edhe të ruajë konfidencialitetin e të dhënave që siguron gjatë kryerjes së ekspertimit.

74. Kur e vlerëson, Këshilli mund të thërrasë ekspertin për të dhënë shpjegime në mbledhjen e Këshillit. Në vendimin e arsyetuar të Këshillit për lejimin ose ndalimin e kandidimit trajtohet edhe nevoja për ekspertim dhe mendimi i dhënë nga eksperti.

75. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPI-së, atyre të nxjerra nga të dhënat që rezultojnë nga shkresat e dërguara nga subjektet publike dhe private, si edhe nga shpjegimet me shkrim të dhëna nga kandidati, relatori vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen e pjesës së relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të pasurisë.

76. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPI-së, atyre të nxjerra nga të dhënat që rezultojnë nga shkresat e dërguara nga subjektet publike dhe private, si edhe nga shpjegimet me shkrim të dhëna nga kandidati, relatori vlerëson se ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të pasurisë dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

77. Ndalimi i kandidimit vendoset në rastet kur ka të dhëna nga burime të ligjshme se kandidati:

a) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;

b) ka fshehur pasurinë dhe të dhënat mbi interesat private, që janë të detyrueshme të deklarohen;

c) ka kryer deklaram të rremë;

ç) gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

78. Ndalimi i kandidimit vendoset edhe në rastet kur kandidati:

a) *ka refuzuar të dorëzojë të dhënat personale të nevojshme për krijimin e llogarisë fillestare në sistemin EACIDS ose nuk i ka plotësuar dhe depozituar formularët pranë ILDKPKI-së brenda afatit;*

b) ka refuzuar nënshkrimin e autorizimeve të kërkuara nga Këshilli për verifikimin e pasurisë.

B. Verifikimi i integritetit të kandidatit

79. Jo më vonë se 3 ditë nga ajo e njoftimit zyrtar për fillimin e procedurës së verifikimit, kandidati paraqitet në zyrën e posaçme të Këshillit pranë Gjykatës së Lartë për të tërhequr, kundrejt nënshkrimit:

a) kopjen fizike të formularit për vetëdeklarim sipas ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

b) kopjen fizike të formularit të aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta”, sipas ligjit nr. 45/2015;

c) informacionin mbi lidhjen elektronike në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë pjesa e caktuar për Këshillin, në të cilën kandidati mund të marrë dhe plotësojë sipas ligjit, në rrugë elektronike, këto formularë deklarimi;

ç) formularin e autorizimit për Këshillin që, në zbatim të pikës 4, të nenit 229, të ligjit nr. 115/2016, të kryejë verifikimin pranë organeve kompetente sipas ligjit, të të dhënave mbi figurën dhe integritetin e kandidatit.

80. Jo më vonë se 5 ditë nga marrja e formularëve të parashikuar në pikën 79 të këtij vendimi, kandidati i dorëzon ato të plotësuar në zyrën e posaçme të Këshillit pranë Gjykatës së Lartë.

81. Vetëdeklarimi i kandidatit sipas ligjit nr. 138/2015 bëhet publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

82. Kryetari i Këshillit e përcjell menjëherë formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015, të plotësuar nga kandidati, në Prokurorinë e Përgjithshme.

83. Prokuroria e Përgjithshme kryen verifikimet sipas ligjit jo më vonë se 30 ditë nga paraqitja e vetëdeklarimit pranë atij institucioni.

84. Gjithashtu, jo më vonë se 5 ditë nga dorëzimi i vetëdeklarimit të kandidatit, të plotësuar sipas ligjit nr. 138/2015, në zyrën e posaçme të Këshillit pranë Gjykatës së Lartë, relatori kryen edhe veprimet për kërkimin e informacionit mbi pengesat ligjore sipas shkronjave “a” dhe “c”, të pikës 89 të këtij vendimi, nga Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar.

85. Formulari i aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta” sipas nenit 29, të ligjit nr. 45/2015, i plotësuar nga kandidati, i dërgohet menjëherë për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

86. Në varësi të rezultateve të kontrollit dhe nevojave të verifikimit të mëtejshëm të integritetit të kandidatit, relatori mund të kërkojë:

a) informacione shtesë nga institucionet e përmendura në këtë seksion;

b) shpjegime me shkrim nga kandidati, i cili, jo më vonë se 5 ditë nga ardhja dijeni, duhet të paraqesë drejtpërdrejt pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë, shpjegimet e tij dhe dokumentet mbështetës. Nëse për motive të justifikuara nuk mund të respektojë afatin 5-ditor, kandidati njofton menjëherë Këshillin. Kur i vlerëson motivet si të justifikuara, relatori i cakton kandidatit një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur shpjegimet lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.

87. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të Prokurorisë së Përgjithshme, si edhe gjetjet e përfundimet e nxjerra nga të dhënat e dërguara nga institucionet e tjera të përmendura në këtë seksion, relatori vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen e pjesës së relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të integritetit të kandidatit.

88. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të Prokurorisë së Përgjithshme, si edhe të atyre të

dërguara nga institucionet e tjera të përmendura në këtë seksion, relatori vlerëson se ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen relacionit mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të integritetit dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

89. Ndalimi i kandidimit vendoset në rastet kur nga Prokuroria e Përgjithshme dhe institucionet e tjera të përmendura në këtë seksion, konfirmohet se kandidati:

- a) ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar;
- b) ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- c) është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës.

90. Ndalimi i kandidimit vendoset edhe kur:

- a) kandidati ka refuzuar të përmbushë detyrimin për t’u pajisur me formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 ose me formularin e aplikimit “Për informim përpara emërimit /zgjedhjes në poste të larta” sipas ligjit nr. 45/2015 apo nuk i ka plotësuar dhe depozituar ato;
- b) kandidati ka refuzuar nënshkrimin e autorizimit për Këshillin që, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe pikës 2, të nenit 237, të ligjit nr. 115/2016, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, lidhur me të dhënat që lidhen integritetin e kandidatit.

C. Verifikimi i kushteve të tjera ligjore të kandidimit

91. Jo më vonë se 3 ditë nga ajo e njoftimit zyrtar për fillimin e procedurës së verifikimit, kandidati pajiset me formularin e autorizimit për Këshillin që, në zbatim të pikës 4, të nenit 229 dhe pikës 2, të nenit 237, të ligjit nr. 115/2016, të kryejë verifikimin në të gjitha subjektet publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, lidhur me të dhënat që lidhen me plotësimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, të përcaktuara në nenin 7/a, të ligjit nr. 8577/2000, për kandidimet në Gjykatën Kushtetuese dhe në nenin 199, të ligjit nr. 115/2016 për kandidimet për inspektorë të lartë të drejtësisë. Autorizimi, i nënshkruar rregullisht nga kandidati, depozitohet pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë, jo më vonë se 5 ditë nga ajo e marrjes në dorëzim.

92. Relatori shqyrtton dokumentacionin e paraqitur nga kandidati për të vlerësuar nëse, për efekt të verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, të dhënat e deklaruara janë të plota, kanë përmbajtje të saktë dhe nuk gjenden elemente që sjellin dyshime për vërtetësinë e dokumentit apo të përmbajtjes së tij.

92/1. Kur nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, relatori vlerëson se nuk është nevojshme kryerja e verifikimeve të mëtejshme lidhur me dokumentacionin, për shkak se të dhënat e deklaruara janë të plota, kanë përmbajtje të saktë ose nuk gjenden elemente që sjellin dyshime të bazuara për vërtetësinë e dokumentit apo të përmbajtjes së tij, ai vijon me procedurën e verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidatit.

93. Kur nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, relatori vlerëson se të dhënat e deklaruara nuk janë të plota, përmbajnë pasaktësi ose edhe elemente që sjellin dyshime të bazuara për vërtetësinë e dokumentit apo të përmbajtjes së tij, ai, pas miratimit të Këshillit, me vendim të arsyetuar përcakton dokumentet për të cilat është e nevojshme rivefikimi i të dhënave, duke kërkuar për këtë qëllim:

- a) informacione nga subjektet publike dhe private;
- b) shpjegime me shkrim nga kandidati, i cili, jo më vonë se 5 ditë nga ardhja dijeni, duhet të paraqesë drejtpërdrejt pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë, shpjegimet e tij dhe dokumentet mbështetës. Nëse për motive të justifikuara nuk mund të respektojë afatin 5-ditor, kandidati njofton menjëherë Këshillin. Kur i vlerëson motivet si të justifikuara, relatori i cakton kandidatit një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur shpjegimet lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.

94. Nëse nga gjetjet e procesit të verifikimit, relatori vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen e pjesës së relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të

ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit.

95. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga kandidati, si edhe nga gjetjet e përfundimet e nxjerra nga shqyrtimi i shkresave të dërguara nga subjektet publike dhe private, relatori vlerëson se ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen relacionit mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

96. Ndalimi i kandidimit vendoset në rastet kur nga dokumentacioni i paraqitur nga kandidati, si edhe nga shkresat e dërguara nga subjektet publike dhe private, rezulton se kandidati nuk plotëson ndonjërin prej kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të parashikuara, përkatësisht, nga neni 7/a i ligjit nr. 8577/2000 për kandidimet në Gjykatën Kushtetuese dhe nga neni 199, të ligjit nr. 115/2016, për kandidimet për inspektorë të lartë të drejtësisë.

97. Ndalimi i kandidimit vendoset edhe kur kandidati ka refuzuar nënshkrimin e autorizimit për Këshillin që, në zbatim të pikës 4, të nenit 229 dhe pikës 2, të nenit 237, të ligjit nr. 115/2016, të kryejë verifikimin në të gjitha subjektet publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, lidhur me të dhënat që lidhen me plotësimin e kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit.

97/1. Ndalimi i kandidimit vendoset në rastet kur nga dokumentacioni i paraqitur nga kandidati, si edhe nga shkresat e dërguara nga subjektet publike dhe private, rezulton se kandidati nuk plotëson kushtin e parashikuar, nga neni 7/a, pika 2, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000, "Për kandidimet në Gjykatën Kushtetuese", në lidhje me përvojën 15 vjet "jurist i nivelit të lartë në administratën publike".

Kandidati "jurist i nivelit të lartë në administratën publike" për qëllim të këtij vendimi, do të konsiderohet juristi i cili ushtron apo ka ushtruar një detyrë të nivelit të lartë drejtues në organet e sistemit të drejtësisë apo administratën publike përmes së cilës ka arritur të akumulojë ndër vite gjatë karrierës së tij/saj një eksperiencë të pasur profesionale lidhur me çështje të së drejtës kushtetuese, të të drejtave të njeriut, të së drejtës publike, që e lejon të japë një kontribut me kualifikim të lartë profesional dhe vlera të çmueshme juridike në juridiksionin kushtetues.

V. Dispozita kalimtare dhe të fundit

A. Fillimi i procedurës së verifikimit të kandidatëve në pozicionet vakante të shpallura dhe të depozituara pranë Këshillit

98. Procedurat e verifikimit të pasurisë, integritetit, si edhe të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidatëve, për pozicionet vakante të shpallura për Gjykatën Kushtetuese dhe, për të cilat, subjektet që vënë në lëvizje Këshillin, kanë depozituar pranë Këshillit dokumentacionin përkatës sipas ligjit, fillojnë jo më vonë se 5 ditë nga ajo e hyrjes në fuqi të aktit nënligjor normativ të nxjerrë nga Këshilli mbi rregullat më të detajuara për vlerësimin, pikëzimin, përzgjedhjen dhe renditjen e kandidatëve në zbatim të pikës 2, të nenit 229, të ligjit nr. 115/2016.

99. Njoftimi zyrtar i Këshillit për fillimin e procedurave ligjore të verifikimit të kandidaturave sipas ligjit nr. 115/2016 shpallet menjëherë në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, si edhe bëhet e njohur nëpërmjet komunikatës së posaçme për mediat.

100. Gjithashtu, ky njoftim zyrtar, i dërgohet individualisht secilit kandidat në adresën elektronike të deklaruar prej tij në dokumentacionin e kandidimit të depozituar pranë Këshillit.

B. Verifikimi i kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidatëve jomagjistratë

101. Afati 180-ditor i përcaktuar nga pika 2 e nenit 3/1, të ligjit nr. 9049/2003, lidhur me procedurën e verifikimit dhe të kontrollit të plotë të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, llogaritet nga dita e dorëzimit të plotësuar të deklaratës së pasurisë dhe interesave private të kandidatit pranë ILDKPI-së.

102. Pavarësisht se në kohën e kandidimit, i ka depozituar të plotësuar pranë subjekteve që vënë në lëvizje Këshillin, jo më vonë se 5 ditë nga marrja e formularëve të parashikuar në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 79 të këtij vendimi, kandidati duhet t'i plotësojë me të dhëna të aktualizuara dhe t'i dorëzojë ato

në zyrën e posaçme të Këshillit pranë Gjykatës së Lartë.

103. Jo më vonë se 15 ditë nga ajo e depozitimit të autorizimit për Këshillin sipas pikës 91 të këtij vendimi, kandidatët duhet të depozitojnë pranë Këshillit deklarime dhe aktet zyrtare përkatëse të reja, me të dhëna të aktualizuara, të lëshuara nga autoritetet kompetente, lidhur përmbushjen e kushteve të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të parashikuara, përkatësisht, në shkronjat “c”, “ç” dhe “d”, të nenit 7/a, të ligjit nr. 8577/2000 dhe në shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”, të nenit 199, të ligjit nr. 115/2016.

C. Verifikimi i kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore së kandidatëve magistratë

104. Kandidatët magistratë dhe subjektet e tjerë që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, për të cilët nuk është dhënë vendim nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të integritetit nga Këshilli. Vendimi i Këshillit, për urdhërimin e lejimit ose të ndalimit të kandidimit sipas neneve 235 dhe 236, të ligjit nr. 115/2016 për këta kandidatë, do të mbështetet në *vendimin përfundimtar të rivlerësimit kalimtar*.

105. Kandidatët magistratë dhe subjektet e tjerë që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, të cilët janë konfirmuar në detyrë *me vendim përfundimtar* nga organet e rivlerësimit kalimtar, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të integritetit, të parashikuar nga nenet 235 dhe 236, të ligjit nr. 115/2016.

106. Jo më vonë se 15 ditë nga ajo e depozitimit të autorizimit për Këshillin sipas pikës 91 të këtij vendimi, të gjithë kandidatët e treguar në pikat 104 dhe 105 të këtij vendimi, duhet të depozitojnë pranë Këshillit deklarime dhe aktet zyrtare përkatëse të reja, me të dhëna të aktualizuara, të lëshuara nga autoritetet kompetente, lidhur përmbushjen e kushteve të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të parashikuara, përkatësisht, në shkronjat “c”, “ç” dhe “d” të nenit 7/a, të ligjit nr. 8577/2000 dhe në shkronjat “ç”, “d” dhe “dh” të nenit 199, të ligjit nr. 115/2016.

107. Pavarësisht nga parashikimet e pikave 104 dhe 105 të këtij vendimi, të gjithë këta kandidatë magistratë dhe subjekte të tjerë që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, i nënshtrohen menjëherë procedurave të verifikimit të integritetit sipas ligjit nr. 45/2015.

108. Procedura e përcaktuar sipas nenit 236, të ligjit nr. 115/2016, për verifikimin e integritetit të kandidatëve magistratë dhe subjekteve të tjerë që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, shtrihet për periudhën pas asaj të datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar për konfirmimin e tyre në detyrë.

109. Afati 180-ditor i përcaktuar nga pika 2 e nenit 3/1, të ligjit nr. 9049/2003, lidhur me kryerjen e procedurës së verifikimit dhe kontrollit të plotë të pasurisë së kandidatëve magistratë dhe subjekteve të tjerë që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, llogaritet nga dita e dorëzimit të plotësuar të deklaratës së pasurisë dhe interesave private të kandidatit pranë ILDKPI-së.

110. Nëse procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidatëve magistratë dhe subjekteve të tjerë që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, fillojnë pas afatit 180-ditor të përcaktuar nga pika 2 e nenit 3/1, të ligjit nr. 9049/2003, procedura e verifikimit të pasurisë së këtyre kandidatëve shtrihet mbi interesat pasurore, private dhe konfliktin e interesit, për periudhën pas asaj të datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar për konfirmimin e tyre në detyrë.

111. Kandidatët magistratë dhe subjektet e tjerë që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, të cilët nuk janë konfirmuar në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, edhe kur ndaj atij vendimi është paraqitur ankim, nuk lejohen të kandidojnë dhe nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas neneve 235, 236 dhe 237, të ligjit nr. 115/2016.

Ç. Rregulla kalimtare për përmbylljen e procedurave të verifikimit

112. Procedurat e verifikimit të kandidaturave për pozicionet vakante nuk mund të përfundojnë përpara se organet e rivlerësimit të kenë dhënë vendim përfundimtar lidhur me kandidatët magistratë dhe subjekte të tjerë sipas procedurës së rivlerësimit kalimtar në zbatim të ligjit nr. 84/2016.

113. Procedurat e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave fillojnë pasi Këshilli të ketë përfunduar procedurat e verifikimit dhe të ketë vendosur për lejimin ose ndalimin e kandidimit të të gjithë kandidatëve jomagjistratë, si edhe të kandidatëve magistratë e subjekte të tjerë që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016.

114. Për pozicionet vakante të përkohshme të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe të shpallura për aplikim nga organet e emërtesës, kërkesat për kandidim të të cilave janë administruar nga Këshilli përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi ndiqen të njëjtat procedura të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, përveç rastit kur afati i ushtrimit të detyrës për këto pozicione vakante të përkohshme përfundon ndërkohë që Këshilli ende nuk ka përfunduar me vendim këto procedura. Në këtë rast Këshilli, kryesisht apo me njoftimin e organit të emërtesës, konstaton faktin e përfundimit të afatit kur ky mandat mund të ushtrohet dhe deklaron me vendim mbylljen e procedurave, duke njoftuar njëkohësisht organin përkatës të emërtesës dhe personat që kanë kandiduar për plotësimin e atij pozicioni vakant të përkohshëm.

Ç/1. Rregulla kalimtare për dorëzimin e formularëve të deklarimit të pasurisë nga kandidatët në formë shkresore

114/1. Për pozicionet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe të shpallura për aplikim nga organet e emërtesës para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në këtë vendim, si dhe aktet nënligjore të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, lidhur me procedurat e deklarimit të pasurisë.

Brenda 3 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, kandidatët për të cilët nuk është hapur llogari fillestare pranë ILDKPKI-së duhet të njoftohen për t'u paraqitur dhe për të dorëzuar në Këshill të dhënat personale të nevojshme për krijimin e llogarisë në sistemin EACIDS nga ana e ILDKPKI-së. Në këtë rast, afatet fillojnë të ecin sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

D. Dispozita të fundit

115. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ardian Dvorani

Lidhja nr. 1

**FORMULAR VETËDEKLARIMI
PËR POZICIONET DREJTUESE TË MBAJTURA NË PARTI POLITIKE NGA
KANDIDATI GJATË 10 VITEVE TË FUNDIT NGA DATA E KANDIDIMIT**

(shtuar me vendimin nr. 2, datë 23.2.2022)

(Plotësohet nga kandidati që konkurren për anëtar të Gjykatës Kushtetuese/Inspektor i Lartë i Drejtësisë)

I. Të dhënat e kandidatit
Gjeneralitetet

Emri	
Atësia	
Mbiemri	

Datëlindja	
Numri ID	

II. A keni mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit? (*Vendosni shenjën X përmbri përgjigjes*)

PO ☐ / JO ☐

(Nëse përgjigjeni PO, tregoni pozicionin drejtues që keni mbajtur, si dhe datën në të cilën keni ndërprerë ushtrimin e pozicionit drejtues):

(**Shënim.** Për qëllime të ligjit, “pozicion drejtues në parti” konsiderohen strukturat hierarkike më të larta, monokratike apo kolegjiale, me natyrë vendimmarrëse dhe udhëheqëse në drejtim të hartimit, miratimit dhe zbatimit të qëllimeve dhe objektivave politikë të partisë përkatëse, ku përfshihen, por pa u kufizuar, rastet si vijon:

- a) kryetar/ kryetar nderi i Partisë;
- b) sekretar i përgjithshëm i partisë;
- c) anëtar i kryesisë së partisë apo i një strukture ekuivalente;

(emër, mbiemër, nënshkrimi)

- d) anëtar i këshillit drejtues apo strukture ekuivalente;
- e) sekretar për një fushë të caktuar;
- f) kryetar i një dege të partisë në rreth;
- g) sekretar i një dege të partisë në rreth;
- h) çdo funksionar tjetër i cili kryen një detyrë apo mban një post që konsiderohet pozicion drejtues sipas statutit të partisë.

Unë, i/e nënshkruari/a _____, me nënshkrimin e këtij formulari konfirmoj, nën përgjegjësinë time ligjore, saktësinë e të dhënave të pasqyruara këtu dhe jam i vetëdijshëm se pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota dhe të pasakta në këtë formular mund të passjellë si pasojë skualifikimin e menjëhershëm, dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i mëtejshëm i funksionit publik.

Datë ____/____/____

(emër, mbiemër, nënshkrimi)

Lista e dokumenteve që duhet të paraqesë kandidati me të cilën vërteton plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore

(shtuar me vendimin nr. 4, datë 23.11.2023)

Kushtet dhe kriteret	Lloji i dokumentit
Zotësi të plotë për të vepruar	Vërtetim nga zyra e gjendjes civile se ndaj kandidatit nuk është marrë vendim për heqjen apo kufizimin e zotësisë për të vepruar <i>(për kandidatët që nuk vijnë nga radhët e gjyqësorit apo të administratës publike)</i>
Arsimi i lartë juridik (diplomë e nivelit të dytë)	Diplomë dhe listë notash e lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë Diplomë dhe listë notash e njësuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore në rastin kur studimet janë kryer jashtë vendit
Mosqenia në procedim penal dhe mosdënimi me burgim për kryerjen e një vepre penale	Vërtetim i lëshuar pas datës së shpalljes së thirrjes për shprehjen e interesit nga prokuroria dhe gjykata se ndaj kandidatit nuk ka filluar procedim penal si dhe vërtetim i gjendjes gjyqësore <i>(dëshmia e penalitetit)</i>
Largim nga detyra për shkaqe disiplinore dhe mospasja e një mase disiplinore në fuqi	Libreza e punës, vërtetim të lëshuar nga punëdhënësi
Vjetërsia në profesion	Libreza e punës, vërtetimi lëshuar nga punëdhënësi, vërtetim sipas rastit nga Dhomat Profesionale me anëtarësi të detyruar, nga QKB apo nga organet tatimore, në rastin e të vetëpunësuarit